



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:084740

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05646046

C. nr.106/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B. K. nga, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Spahiu, avokat nga Gjilani, kundër të paditues Komuna e Kamenicës – Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, jashtë seancës gjyqësore, më datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia me numër C.nr.106/2024, e datës 13.03.2024, e paditëses B. K. nga, e paraqitur kundër të paditues Komuna e Kamenicës, lidhur me çështjen juridike kontestimore për kompensimin e shujtës ditore.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja B. K. nga, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, me datë 13.03.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi, kundër të paditues Komuna e Kamenicës, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, me vlerë të kontestit prej 428.00 euro.

Përfaqësuesi i paditëses, përmesë parashtresës së datës 24.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë me arsyetimin se për të njëjten çështje juridike është paraqitur padi nga një avokat tjetër dhe se janë dakorduar me palën paditëse që ta tërheqë padinë, ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar

Gjykata, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizion Civil
C. nr.106/2024, më datë 29.04.2024

Numri i lëndës: 2024:084740
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05646046

Gjyqtari,
Artan Abazi d,v

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.